

VENDIM
Nr. 209, datë 17.8.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 167, DATË 28.6.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SALLARI ENERGY TRADE’ SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/1 prot., datë 11.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 28.6.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Shoqëria kishte detyrimin që të informonte ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

- ERE, njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.6.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 469/9 prot., datë 1.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, brenda afatit të përcaktuar.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka kompetencë të nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Salillari Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti